


DR. ZIHNI HASKAJ**(1937-2011)**

Më 6 tetor 2011, pas një sëmundje të rëndë u nda nga jeta kolegu ynë, historiani Zihni Haskaj.

Dr. Haskaj lindi në Dragot të Tepelenës më 4 qershor 1937. Arsimimin e ulët e kreu në Tepelenë, në shkollën 7 vjeçare të këtij qyteti. Studimet universitare për gjuhë-letërsi gjermane i filloi në Laipçig të Republikës Demokratike Gjermane, për të vazhduar më pas në Universitetin e Tiranës, në degën gjuhë-histori.

Zihni Haskaj ka punuar si mësues e drejtues arsimi në Tepelenë, si pedagog universiteti e kërkues shkencor në Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave dhe disa vite si ambasador i Shqipërisë në Austri.

Zihni Haskaj është autor dhe bashkautor i disa punimeve për periudha të ndryshme historike. Ka botuar disa libra dhe mjaft artikuj shkencorë, referate e kumtesa. Pas daljes në pension në vitin 1993 Zihni drejtoi Shoqatën Atdhetare Kulturore e Shkencore “Ali Pashë Tepelena” dhe gazetën “Tepelena jonë”. Që nga viti 1991 ishte zgjedhur kryetar i “Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Gjermani”.

Gjatë veprimtarisë së tij shkencore gati 25 vjeçare në Institutin e Historisë Zihni u fokusua kryesisht në studimet për Rilindjen Kombëtare Shqiptare, fryt i së cilës ishin veprat e botuara të tilla si: “Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (përmbledhje artikujsh nga shtypi)” (1971), “Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit” (me bashkautor), në vitin 1972, vëllimin e dytë i botimit “Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare” (1976), “Problemi i autonomisë së Shqipërisë gjatë kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912 sipas shtypit të kohës (1985) etj. Dr. Zihni ka botuar një numër artikujsh në revistën “Studime Historike”, “Studime Filologjike”, “Gjurmime Albanologjike” (Prishtinë), si dhe shumë artikuj të tjerë shkencorë e publicistikë në shtypin shqiptar. Tematika e botimeve të tij është fokusuar kryesisht tek periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe tek figurat e shquara të kohës, si vëllezërit Frashëri, Jashar Erebara, Shahin Kolonja, Bajo Topulli, Bajram Curri, Hasan Prishtina, Isa Boletini, Sotir Peci, Sali Nivica, Themistokli Gërmenji etj. Studimet e tij janë rezultat i punës këmbëngulëse por edhe i kërkimeve në arkivat shqiptare e të huaja, si në Vjenë, Budapest, Zarë, Sarajevë, Beograd, Prishtinë, Shkup etj. Zihni punoi dhe zhvilloi aftësitë e veta si historian në një sektor me emër në Institut, siç ishte ai

i Rilindjes, në të cilin punonin disa nga historianët e spikatur të vendit, të tillë si Kristo Frashëri, Kristaq Prifti, Stefanaq Pollo, Zija Shkodra etj.

Një kontribut të rëndësishëm Zihniut ka dhënë edhe si mësues në Universitetin e Tiranës dhe si drejtues i temave studimore të jo pak studentëve të këtij universiteti.

Pas daljes në pension Zihniu nuk e ndërpreu veprimtarinë shkencore, publicistike e shoqërore. Kësaj kohe i përkasin një varg botimesh kushtuar figurave me rezonancë kombëtare e lokale. Si drejtues i shoqatës “Ali Pashë Tepelena” dhe i gazetës së saj, ai ka përkujtuar e promovuar vlerat më të mira të kësaj treve.

Ndarja e Zihniut nga jeta është një moment i dhimbshëm, jo vetëm për familjen por edhe për ne kolegët e tij.

BIBLIOGRAFI SHKENCORE **Botimet kryesore të dr. Zihni Haskaj**

I. Monografi, përmbledhje studimesh e dokumentesh

1. *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (përmbledhje artikujsh nga shtypi)* (1979-1908), vëll. I, botim Uinversitetit të Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë “Mihal Duri”, 1971, 512 f.
2. *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: “Mihal Duri”, 1972 (me bashkautor), 447 f.
3. *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare* (1908-1910), vëll.II, Tiranë: “Mihal Duri”, 1976, 648 f.
4. *Problemi i autonomisë së Shqipërisë gjatë Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912, sipas shtypit të kohës*, Tiranë: 1985.
5. *Kalo Brahim Xhaferaj, Një jetë në këmbë për mëmëdhenë*, Tiranë: 2004, 142 f.
6. *Bektash Zite – 40 vjet gazetar me penë në dorë*, Tiranë: “Geer”, 2006, 207 f.
7. *Fjala e parë – Atdhetarizmi. për Tepelenën dhe tepelenasit, 2000-2006*, Tiranë: “Geer”, 2004.

II. Bashkautor

1. *Dino Malo Islamaj – mësuesi atdhetar i Dhëmbllanit*, Tiranë: “Geer”, 2004, 227 f.
2. *Ali Rakip Manaj – vullneti që lartëson njeriun*, Tiranë: “Geer”, 2006.

III. Artikuj studimorë e kumtesa

1. “Jehona e Lidhjes së Prizrenit në Lëvizje për çlirimin kombëtar (1881-1912)”, në *Studime historike*, nr. 4, Tiranë: 1968, f. 145-151.
2. “Programi politik i Lëvizjes sonë Kombëtare në organet e shtypit shqiptar në prag të Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912”, në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1983, f. 109-127.
3. “Roli reaksionar i klerit ndaj problemeve të alfabetit (1879-1912)”, në *Jehona*, nr. 10, Tiranë: 1973, f 62-69 dhe në *Studime historike*, nr. 1, Tiranë: 1969, f. 83-92.

Hamit KABA